



Duke u mbështetur në nenin 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, nenit 33 të Statutit të Komunës së Klinës, nenit 15 dhe 16 dhe 17 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa i Komunës së Klinës, bën këtë:

F T E S Ë

Ftohen të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, të marrin pjesë në mbledhjen e VII-të të KPF-së e cila mbahet me datë: 14.07.2023 në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës, duke filluar me punë në ora 09:00.

R E N D I I D I T Ë S

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
3. Shqyrtimi i raportit të menaxhimit financiar për periudhën janar-qershor 2023,
4. Shqyrtimi i raportit të auditimit të jashtëm për vitin 2022,
5. Shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimit të auditorëve të jashtëm,
6. Shqyrtimi i procesverbalit nga takimi i parë me qytetar i mbajtur nga kryetari i komunës me datë: 26.06.2023,
7. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin qershor - korrik 2023,
8. Të ndryshme.

01Nr. 16 - 22461 2023
Klinë, më 07.07 2023



Kryesuesi,
Fadil Gashi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Osloňjajući se na član 52 Zakona br.03/L-040 o Lokalnoj Samoupravi, član 33 Statuta Opštine Klina, član 15, 16 i 17 Pravilnika Rada Skupštine i Skupštinskih Komiteta, Predsedavajući Komiteta za Politiku i Finansije Skupštine Opštine Klina vrsi sledeće:

OBAVEŠTENJE

Obaveštavaju se svi članovi Komiteta za Politiku i Finansije da prisustvuju VIIIm KPFA dana 14.07.2023 od 9.00 casova u sali skupstine opštine.

DNEVNI RED

1. Obrazloženje izostanaka,
2. Razmatranje i usvajanje zapisnika sa prethodnog sastanka,
3. Razmatranje izveštaja o finansijskom upravljanju za period januar-jun 2023 godine,
4. Razmatranje izveštaja eksterne revizije za 2022 godinu,
5. Razmatranje akcionog plana za sprovođenje preporuke vanskog revizora,
6. Razmaranje zapisnika sa prvog sastanka gradonačelnik sa građanima dana 26.06.2023.
7. Razmatranje podnetih zahteva komiteta za politiku i finansije za mesec jun - jul 2023.
8. Razno.

01Br. 06 - 22461 2023
Klina 07, 07 2023



Predsedavajući,
Fadil Gashi

Lënda:Kërkesë

Komuna Klinë

Kryesuesit të Asamblesë Komunale të Klinës;Fadil Gashi

Data:14.06.2023

MINISTRI I BASHKËSHTETËSIAE DHE PUNËVE SHËRBËTORE
KOMUNA KLINË

Pranuar me dt. 14,06,2023
Faqe nr 1
Pranohet nga

Org. nr.	Sh. nr.	Sh. nr.

01-586-19771/23

Kërkesë

I dashur Kryesues i asamblesë së Komunës së Klinës z.Fadil Gashi, kërkojm nga ju si kryesues i Asamblesë të Komunës së Klinës që të shikoni mundësin për caktimin e një sheshi në qytetin e Klinës me emrin e Heroit të Kombit Ali Ahmet Berisha .

Me respekt nga nismetaret e kesaj kerkese:

Binak Gashi, ✓ B.Gashi 23

Xhemë Morina, ✓ Xhemë Morina

Hamdi Morina

Shani Berisha, ✓ Shani Berisha

Faton Berisha, ✓ F.Berisha



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

DREJTORIA E FINANCAVE, EKONOMISË DHE ZHVILLIMIT

05-Nr. 052-22165/2023

Klinë më dt: 05.07 /2023

PËR: Kuvendin e Komunës -Kryesuesit Z.Fadil Gashi.

PËRMES: Kryetarit të Komunës z.Zenun Elezaj,

NGA : . Drejtori i Drejtorisë Për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim z.Enver Berisha.



LËNDA: Kerkesë për shqyrtim të Raportit financiar Gjashtëmujor 01 Janar-30 Qershor 2023

Duke u bazuar në Ligjin Për Menagjimin e Financave Publike dhe Pergjegjësitë, Ligjin Për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjin Për vetqeverisjen Lokale dhe Statutit të Komunës, kërkojm nga Kshilltaret Komunal qe të shqyrtoji Raportin financiar Gjashtëmujor 01 Janar-30 Qershor 2023.

Arsyeshmeria e marrjes se kësaj procedure qendronë se Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit pas aprovimit nga Ekzekutivi ka pregaditur raportin financiar Gjashtëmujor 01 Janar-30 Qershor 2023

Me respekt.

Kryetari të Komunës së Klinës

KUVENDIT KOMUNAL KLINË
KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA

KOMUNA E KLINËS MUNICIPALITY OF KLINA OPSTINA KLINA			
Pranuar me dt. Received on Priliceno dana			
22.06.2013			
Nr.	Numer	Titolo	Amount Vrednost
e Refki Hysen Gashi, Ekonomist, Arpapunë, adresa: Rr. "Skender Rexhepi", nr. 33, Klinë			
01-463-20549/23			

LËNDA: KËRKESË

1. PËR RREGULLIMIN E PROBLEMATIKËS SË TRUALLIT TE KOMPLEKSI "BENITA";
2. PËR RREGULLIMIN E ÇËSHTJES SË KOMPENZIMIT TË DËMIT NDAJ QYTETARIT

Qytetari Refki Hysen Gashi, nga Klina, Komuna e Klinës, kishte berë kërkesë në vijën e rregullt administrative për marrjën e truallit në sipërfaqe prej 5 ari, prej të cilave 3 ari e 40 metra janë të përshkruara në ngastrën kadastrale numër P-71006024-00525-15, e cila evidentohet në Çertifikatën pronësore numër 768, ZK Klinë, si pronë shoqërore e Kuvendit Komunal në Klinë, ndërsa pjesa tjetër prej 0.01.60 ha, poashtu evidentohet në të njëjtën Çertifikatë pronësore.

Trualli i përmendur ishte i lirë dhe qytetari i kishte bashkangjitur dokumentacionin e nevojshëm për ndërtimin e një objektit individual dhe personal afaristo - banesor, duke i paguar taksat e nevojshme dhe pagesat e nevojshme për shfrytëzim të përhershëm për 500 m² (5 ari).

Sipas planit urbanistik të Komunës së Klinës, trualli i përmendur ishte tokë ndërtimore urbane. Dokumentacionin e gjeodezisë në pajtim me rregullativën komunale e ka punuar i ndjeri Selim Berisha, drejtor i gjeodezisë dhe gjeodeti Nysret Gashi, punëtor i kësaj gjeodezie, ndërsa pjesën e rregullativës urbanistike e kanë punuar punëtorët e atëhershëm të urbanizmit Elez Lecaj dhe punëtori tjetër Nedelku.

Papritmas në hapësirat e këtij trolli ndërhyu Krasiq Milivoj, punëtor i pylltarisë duke e pamundësuar vazhdimin e punës së qytetarit - paraqitësit të kësaj kërkesë. Qytetari Refki Gashi, e rezervon të drejtën për marrjën e truallit të përmendur me krijimin e kushteve dhe rrethanave të volitshme në të ardhmen.

Paraqitësi i kësaj kërkesë ka paraqitur kërkesë me shkrim me 19.06.2006, për rregullimin e kësaj problematike te Organet Administrative Udhëheqëse të Komunës së Klinës. Edhe pse kanë qenë në dijeni edhe atëherë edhe tash, organet kompetente komunale e kanë injoruar kërkesën e qytetarit duke marrë masa dhe veprime në kundërshtim me interesin e qytetarit, duke i berë atij dëm të madh.

Vlenë të përmendet fakti se paraqitësi i kërkesës qytetari - Refki Gashi, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë zyrtarë administrativ, zyrtarë i lartë i zgjedhur i Klinës, dhe Kosovës. Prandaj këtu bëhet fjalë për një udhëheqës komunal të Komunës së Klinës, dhe Kosovës, i cili ka punuar sa ka pasë Kosova Kushtetutë dhe puna e tij nga qytetarët dhe organet që ai i ka përfaqësuar është vlerësuar si histori e lartë suksesi.

Kuvendi Komunal i Klinës, kështu shkeli të drejtën e qytetarit të tij një herë, mirëpo vazhdoj me shkeljen për të dytën herë duke ardhur si investitor i drejtëpërdrejtë me kompaninë "Benita" dhe firmën "Citadela", duke kryer veprime ndërtimore në rrethinën e truallit të qytetarit Refki Gashi, dhe të pjesës së tij, duke zhvilluar plan afaristo - banesor, qendër e madhe tregtare me shumë blloqe, në koncesionin komunal 30 me 70, por qytetarin me lëndë shfrytëzim të përhershëm e lenë jashtë projektit, porse hapësirat e tij i shfrytëzon edhe sot e kësaj dite, duke i berë qytetarit dëm të madh, edhe sot e kësaj dite pa i dhënë kurrfarë kompenzimi.

Qytetari Refki Gashi, mendon se organet kompetente komunale shkallë - shkallë duhet të ndërmarrin masa dhe veprime urgjente me qëllim të përmirësimit të padrejtësisë. Integriteti moral i qytetarit është i shenjt, marrëdhënia e punës së qytetarit është e shenjt, prona e qytetarit është e shenjt dhe besoj se organet komunale do të reflektojnë pozitivisht me qëllim të rregullimit të kësaj problematike në marrëveshje me qytetarin.

Prona e dhënë në shfrytëzim në afat prej 99 vjetësh, ose afat gjatë e largon qytetarin me lëndë në shfrytëzim të përhershëm duke shkelur detyrat punuese të gjeodezisë dhe urbanizmit se me rastin e rregullimit të zemres së qytetit duhet të hartoj raport dhe të filloj punën me qytetarin në fjalë. Këtu shkilet statuti i Komunës së Klinës, pika e 15-të, e cila i jep të drejtën qytetarit pjesëmarrjen e tij në vetqeverisjen lokale me qëllim të marrjës së vendimeve për të qenë efektive në praktikë. Poashtu shkelet pika 38 e këtij statuti e cila tregon të drejtën e qytetarit në qasjen e dokumenteve zyrtare ku qytetari kishte lëndën e tij. Me informimin me lëndën e qytetarit kuvendi do të kishte mundësi të gjente zgjidhje të drejtë dhe meritore. Vazhdon të shkelet Ligji për Vetqeverisje Lokale, pika 55 e statutit të Klinës, ku Kuvendi i Komunës, dhe akterët e tjerë në këtë ngjarje marrin vendime duke krijuar pasuri dobisore për vehten e tyre dhe partnered e tjerë e në dëm të qytetarit - paraqitësit të kësaj kërkesë, me çrast shkaktohet konflikt i rëndë i interesit në dëm të qytetarit Refki H. Gashi. Për qytetarin i cili paraqiti fakte dhe argumente respektivisht raport në këtë çështje, lënda përfundon kur drejtësia të vendoset në vend.

Në Klinë, me

22.06.2023.


KËRKESEN E PARASHTRON:

Refki Hysen Gashi,

Ekonomist, i papunë,

adresa: Rr. "Skender Rexhepi", nr. 33,

Klinë, Republika e Kosovës





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO
 MINISTRIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE / MINISTARSTVO JAVNIH SLUŽBI / MINISTRY OF PUBLIC SERVICES
 AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

ÇERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

MBI TË DREJTAT E PRONËS SË PALUAJTSHME / O PRAVIMA NA NEPOKRETNU IMOVINU / FOR THE IMMOVABLE PROPERTY RIGHTS

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office	Klinë/Klina/Klinë
Prona e Paluajtshme / Nepokretnu Imovinu / Immovable Property:	P-71006024-00525-15 <i>sp. m. 768</i>
Data dhe Koha e Lëshimit / Datum i Vreme Izdavanja / Date and Time of Submission:	3/12/2012 - 1:40:24PM
Komuna / Opština / Municipality:	Klinë/Klina/Klinë
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	KLINË/KLINA/KLINË

A PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të Drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. ID Lb. ID ID No.	Vendbanimi Prebivalište Residence	Rruga Ulica Street	Nr. Br. No.	Kati Sprat Floor	Pjesa e pronës Deo imovine Part of scale	Azhuruar Azurirano Updated
Posedues Posednik Possessor	PRONË SHOQËRORE-KUVENDI KOMUNAL KLINË	KCID1004672	KLINË				1/1	Nga/Od/From KCID

B NJËSIA E PRONËS SË PALUAJTSHME - JEDINICE NEPOKRETNE IMOVINE - IMMOVABLE PROPERTY UNIT

Nr. i Njesisë Br. Jedinice Unit No.	Llojet e Pronës Vrsta Imovine Property Class	Zona U/R Zona U/R Zone U/R	Shfrytëzimi Aktual Aktuelna Upotreba Actual Use	Vendi i quajtur Zvano mesto Place Name	Rruga Ulica Street	Nr. Br. No.	Kati Sprat Floor	Dhomat Sobe Rooms	Katet Spratovi Floors	Sipërfaqja (m ²) Površina m ² Area	L.Ndërtimore D.Izgradnje C.License	Azhuruar Azurirano Updated
P-71006024-00525-15	Parcelë Parcela Parcel	Urban Urban Urban		STUPOVI-						340	-	

Referenti / Referent / Referent

Pamulina

3/12/2012



Drejtori / Direktor / Director

Pamulina



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO



KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

www.komuna-klina.org

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

Projekt: Ndryshimet dhe Plotësimet

STATUTI I KOMUNËS SË KLINËS

Klinë, shkurt 2010

47. Siquevë
48. Stupë
49. Ujmirë
50. Videjë
51. Volljakë
52. Zabërgjë
53. Zajm
54. Zllakuqan

V Mi' 78

Vendbanimet e Komunës së Klinës dhe forma e organizmit të tyre përcaktohen me Ligjin përkatës dhe Vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës.

W Lagjet urbane të Komunës së Klinës janë:

1. Qendra e qytetit
2. Arbëria (ish-Perlina)
3. Dukagjini
4. Tikveshi

Neni 13

Kuvendi i Komunës në aspektin administrativ dhe politik territorin e komunës e organizon në kuptim të Ligjit për Kufijtë Administrativ të Komunave, ndërkaq që kjo çështje më për së afërmi përcaktohet me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës.

Neni 14

Kuvendi i Komunës do të sigurojë kushte që të gjitha shërbimet komunale të shtrihen në të gjitha bashkësitë, fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane dhe format tjera të organizmit në mënyrë të drejtë, të barabartë dhe efikase, pa diskriminim ose favorizim politik.

Specifikimi, përkatësisht përkufizimet e emërtimeve të organizmit administrativ, si dhe mënyra e emërimit të personelit do bëhet në pajtim me LVL-në dhe ligjet e tjera që rregullojnë këtë çështje.

Për të siguruar plotësimin e të gjitha nevojave të qytetarëve dhe ushtrimin e përgjegjësive nga autoritetet lokale sa më afër qytetarëve, Komuna përmes Kuvendit të Komunës apo Kryetarit të Komunës vendosë të bëjë aranzhime me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane brenda territorit të sajë.

PJESA E IV-të: KONSULTIMET DHE PJESËMARRJA E PUBLIKUT NË VENDIMMARRJE

Neni 15

Komuna do të bëjë konsultimet me publikun në mënyrë që të sigurojë që vendimet e miratuara nga ana e saj të jenë të bazuara fuqishëm në fakte dhe që janë marrë parasysh pikëpamjet dhe përvojat e qytetarëve para marrjes së vendimeve dhe të sigurohet që vendimet e propozuara mund të implementohen efektivisht edhe në praktikë.

Neni 35

3. Komitetet tjera komunale

Kuvendi i Komunës themelon edhe komitete të tjera për të cilat konsideron se janë të nevojshme për kryerjen e përgjegjësive të tyre (neni 51 pika 51.2 dhe 51.3 të LVL-e), kjo sipas specifikës komunale dhe drejtorive tjera të themeluara, duke respektuar përvojën adekuate dhe kriteret profesionale.

Numri i anëtarëve të këtyre komiteteve duhet të jetë së paku 5 e më së shumti 7.

Emërtimi, struktura e tyre dhe çështjet tjera përcaktohen me vendimin e formimit të tyre nga Kuvendi i Komunës.

Neni 36

Komitetet këshillëdhënëse duhet të paraqesin pikëpamjet dhe mendimet e qytetarëve tek Kuvendi i Komunës.

Në kryerjen e detyrave të tyre, Komitetet këshillëdhënëse sektoriale duhet të punojnë së bashku me Komitetet e Kuvendit në mënyrë të tillë që vendimet e Komiteteve të Kuvendit apo të Kuvendit të Komunës të merren mundësisht pas konsultimeve me komitetin këshillëdhënës përkatës sektorial.

Anëtarët e komiteteve këshillëdhënëse duhet të emërohen me mandat 3 - vjeçar në baza të rregullta, ku 1/3 e anëtarëve duhet të emërohet çdo vit.

Asnjë anëtar i komitetit këshillëdhënës nuk mund të shërbejë më shumë se dy mandate të një pas njëshme.

Gjuha zyrtare

Neni 37

Çështja e gjuhës zyrtare në përdorim është e rregulluar më për së afërmi me Ligjin e veçantë për përdorimin e gjuhës zyrtare nr. 02/L-37 i shpallur në Fletën zyrtare të UNMIK-ut nr. 2006/51, si dhe në Rregulloren komunale për Përdorimin e gjuhës zyrtare në Komunë.

KAPITULLI I III-të: QASJA NË DOKUMENTET ZYRTARE

Neni 38

Qasja në dokumentet zyrtare komunale është e rregulluar më për së afërmi me Ligjin e veçantë për qasje në dokumentet zyrtare nr. 2003/12 i shpallur në Fletoren zyrtare të UNMIK-ut nr. 2003/32 si dhe në Rregulloren komunale për konsultim dhe pjesëmarrje të publikut në vendimmarrje.

PJESA E V-të: KUVENDI I KOMUNËS, KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS DHE VENDIMARRJA NË KUVEND DHE KOMITETE

Funksionet dhe kompetencat e Kuvendit të Komunës

Kompensimi nga alineja e më sipërme përcaktohet me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës.

KAPITULLI I II-të: KONFLIKTI I INTERESIT I ANËTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Neni 54

Anëtarët e Kuvendit të Komunës nuk mund të jenë edhe anëtarë të emëruar në Ekzekutivin dhe Administratën e Komunës (neni 38 i LVL-e).

Përrjashtimet për shkak të konflikteve të interesit bëhen në bazë të nenit 38 të LVL-e, dhe duhet të shënohen në procesverbalin e mbledhjes të Kuvendit të Komunës.

Neni 55

Anëtarët që kanë konflikt të interesit në lidhje me një çështje të caktuar nuk duhet të flasin e as të votojnë për çështjen për të cilën kanë konflikt të interesit dhe duhet të dalin nga salla e mbledhjes atëherë kur diskutohet ajo çështje.

Nëse vije deri të ndonjë konflikt potencial i interesit pasi që është marrë vendimi, por para se të implementohet ai, vendimi duhet të suspendohet dhe çështja duhet të hetohet.

Nëse arrihet në përfundim se ka ekzistuar konflikti i interesit, vendimi duhet të anulohet tërësisht dhe duhet të bëhet një vendim i ri.

KAPITULLI I III-të: MARRËDHËNIET NDËRKOMUNALE DHE PARTNERITETIT

Neni 56

Kryetari i Komunës pas konsultimeve me Komitetin për Politikë dhe Financa duhet të prezantoj rekomandimet për Kuvendin e Komunës për marrëveshjet të cilat mund të jenë të nevojshme në bazë të nenit 28 dhe 29 të LVL-e.

Kuvendi i Komunës vendos për lidhjen e marrëveshjeve ndërmjet komunave për ushtrimin e përgjegjësisë dhe pushtetit në bashkëpunim me njëra tjetrën.

Neni 57

Bashkëpunimet tjera komunale dhe ndërkomunale

Më qellim të krijimit të kushteve për investime në ekonomi dhe avancimin e vlerave kulturore, arsimore dhe sportive si dhe zhvillimin e gjithëmbarshtëm, komuna mban lidhje të drejtpërdrejta dhe bashkëpunon më qytetar të cilët përherë apo përkohësisht janë shpërngulur nga territori i Komunës në ndonjë vend tjetër të Kosovës apo në botën e jashtme.

Bashkëpunimi mund të bëhet edhe me qytete dhe komuna të tjera në botën e jashtme, me organizata qeveritare dhe jo qeveritare vendore dhe ndërkombëtare, krejt kjo në pajtim me politikën e përcaktuara nga niveli i pushtetit qendror.

- Bën azhurimin - përkthimin e pronës në bazë të dokumenteve valide ligjore dhe të verifikuara,
 - Zyra komunale kadastrale është përgjegjëse për zhvillimin dhe organizimin e kapaciteteve kadastrale, rrjetin referues homogjen, për sigurimin e hartave Orto - foto, rikonstruimin e informatave kadastrale në formë digjitale, modelin e sistemit informativ mbi tokën dhe pronën,
 - Kryen shërbimet e mirëmbajtjes së klasifikimit dhe kulturave të tokës,
 - Harton regjistrin e uzurpimeve sipas komunave kadastrale,
 - Mbron pronën komunale nga uzurpimet e ndryshme,
 - Kryen procedurat rreth transaksioneve të pronës shoqërore - komunale dhe procedurat e blerjes dhe shitjes të pronës për nevoja të Komunës,
 - Shqyrton dhe kryen procedurat administrative për kthimin e tokës pronarit të mëparshëm,
 - Kryen të gjitha punët administrative dhe shërbimet tjera nga lëmi i marrëdhënieve pronësore- juridike,
 - Kryen të gjitha punët administrative dhe shërbimet tjera nga lëmi i kadastrit sipas Ligjit për Kadastrin,
 - Mban regjistrin zyrtar të zonave kadastrale si dhe regjistrimin e ngastrave kadastrale, ndërtesave, pjesëve të ndërtesave, përçuesve dhe objekteve nëntokësore, regjistrimit të pronës dhe punët tjera në kuptim me Ligjin për Kadastrin dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi,
 - Kryen të gjitha shërbimet gjecode të rreth matjeve, ndarjeve të ngastrave në territorin e Komunës së Klinës, sipas kërkesave zyrtare dhe të palëve,
 - Harton raporte, historiate dhe ekspertiza të pronave sipas kërkesave zyrtare dhe të palëve.
-
- Kryen të gjitha procedurat administrative lidhur me shpronësimet dhe veprimet tjera procedurale sipas kërkesave të subjekteve tjerë apo edhe Komunës sipas Ligjit për Shpronësimet,
 - Ofron ndihmën tjetër juridike të kërkuar nga të gjitha organet tjera sa i përket çështjeve pronësore - juridike,
 - Mban raportet dhe korrespondencën zyrtare me Agjencionin Kadastral të Kosovës,
 - Kryen punë dhe përgjegjësi të tjera të caktuara nga Kryetari i Komunës, e në pajtim me ligjin përkatës.

10. Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Neni 84

Specifikimi i detyrave dhe përgjegjësi janë:

- Organizon dhe shënon data dhe takime me rëndësi kulturore dhe historike,
- Menaxhon resurset lokale kulturore si dhe resurset e trashëgimisë kulturore,
- Bëhet mbikëqyrja dhe mirëmbajtja e arkivit historik komunal, konform Ligjit për Lëndën arkivore dhe arkivat,
- Mirëmban dhe mbikëqyrë punën e Bibliotekave publike,
- Mbështet aktivitetet teatrale brenda territorit komunal,
- Mbështet qendrat e artit dhe të kulturës,

Në bazë të kërkesës së palës :

KOMUNA KLINË

DREJTORIA PËR KADASTER,
GJEODEZI DHE PRONËSI

Rafik Gjensh Gashi

nga

Klinë

Drejtoria lëshon këtë :

Komuna kërkesëtarë Klinë

Hetëp-sëdimi nr. 768


KOPJE PLANI

R.D.nr. 6

PRONARI, SHFRYTËZUESI :

Provi Shqiptare Kuvendi Komunal Klinë

Shk. e zvog. 1: 1000



Tomi i vendit i regjistruar te ziknava kadastreale NR. 11-1066/1

Nr. regjistruar	Kultura	Klasa	Tropi - vendi i kushtuar	Sipërfaqja			Te ardhurat kadastreale
				ha	ca	da	
525/15	urbane	-	Gjensh	3	40		
				3	40		

Çdo kopje është e bërë në origjinalin të vetë sipas gjendjes së fjalës në kadastrë, vlerëson :

Pranuesi:
Gjensh Gashi

Pranuesi:
[Signature]

DATA: 12.03.2012.



Kuvendi i Komunës Klinë
Komiteti për Politikë dhe Financa
01Nr _____/23
Klinë,dt: _____/23

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e VI-të e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur, më 16.06.2023, me fillim nga ora 09:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi, z. Fadil Gashi, i cili përshëndeti të gjithë anëtarët e Komitetit, OSBE-në, drejtorë të drejtorive dhe të pranishmit.

Kryesuesi, prezantoi rendin e ditës:

- 1. Arsyetimi i mungesave,**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,**
- 3. Shqyrtimi i Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore 2024-2026,**
- 4. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Drejtorisë së FEZH për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake,**
- 5. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa, për muajin maj-qershor 2023,**
- 6. Të ndryshme.**

Fadil Gashi, Kryesues: Nëse pajtoheni, ne kishim filluar me mbledhjen e rregullt të KPF-së, meqë jemi 6 anëtarë. Azdren Ramadani veç ka treguar se s'mund të merr pjesë sepse është jashtë Kosovës.

Rendin e ditës besoj që e keni, materialin e keni, nëse ka dikush për rend të ditës, kush është për?

Me 6 vota PËR, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratua rendi i ditës.

Pika 1. Arsyetimi i mungesave.

Fadil Gashi, Kryesues: Unë sapo e thash se veç një konfirmim e kam te Azdreni, 6 anëtarë tjerë jemi prezent.

Pika 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,

Fadil Gashi, Kryesues: Po hap debat për procesverbal, nëse ka dikush, nëse s'ka, kush është për?

Me 6 vota PËR, asnjë kundër, u miratua procesverbali i seancës së kaluar.

Pika 3. Shqyrtimi i Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore 2024-2026.

Fadil Gashi, Kryesues: Ju dhe ne, tani më e kemi një përvojë të mjaftueshme në ndërtimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore. Akoma është duke u arsyetuar edhe nëpër terren, ne veç e kemi marr agjendën edhe në seancë të rregullt të Kuvendit kur e kemi lëshuar në diskutim publik draftin e kornizës, tash nuk e di sa është pjesëmarrja e anëtarëve të Kuvendit edhe të KPF-së, po KPF-ja veç ka obligime me qenë pjesë e atyre debateve. Po ju inkurajoj secilin edhe këto pak çka kanë mbetur në terren, që po zhvillohen debate për Kornizën Afatmesme Buxhetore, nëse mund të ju bashkoheni pjesës, se ne kemi obligim, e dyta është performanca që ne duhet ta plotësojmë edhe si performancë, sepse drejtorja dhe ekzekutivi janë duke e zhvilluar këtë në terren dhe i kanë përcaktuar lokacionet ku mbahen.

Unë s'po marr më shumë kohë, e kemi drejtorin këtu, nëse dëshiron të na bëjë një prezantim rreth kornizës, pastaj hapim debat.

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Faleminderit, kryesues, të nderuar anëtarë të KPF-së, i nderuar drejtor i OSBE-së, z. Driton Marku! Ashtu siç e tha kryesuesi i Kuvendit, ne jemi në fazën e debateve publike rreth Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitin 2024-2026, edhe në seancën e fundit të asamblesë komunale, ne kemi pasur thirrjen që anëtarët e Kuvendit dhe gjithë qytetarët të bëhen pjesë e këtyre debateve. Ky buxhet që është i planifikuar për vitin 2024 e tutje, është buxhet që u shërben qytetarëve dhe qytetarët është mirë të bëhen pjesë e këtyre debateve, për shkak se i ofrojnë idetë e veta, i ofrojnë projektet e veta, dhe na ofrojnë bashkërisht. Ekzekutivi, Kuvendi dhe qytetarët bëhen pjesë të një drafti që në një formë do të jetë i pranueshëm për gjithë në fazën vijuese të kësaj Kornize Afatmesme Buxhetore.

Ne, siç e tha edhe kryesuesi, veç kemi filluar nga dita e djeshme me debatet me publikun, ishim mbrëmë në bashkësinë lokale të Sferkës, në bashkësinë lokale të Gllarevës dhe në bashkësinë lokale të Ujmirit, ndërsa sot e vazhdojmë me bashkësinë lokale të Jashanicës dhe të Drenocit, ndërsa javën tjetër vazhdojmë me bashkësitë lokale, Grabanicë Zajm, Budisalc dhe Zllakuqan.

Meqë edhe përmes mikrofonit të këtij Kuvendi, unë u bëj thirrje të gjithë anëtarëve të Komitetit, anëtarëve të Kuvendit dhe gjithë qytetarëve të këtyre zonave, që të bëhen pjesë e këtyre debateve me qytetarë, me të vetmen arsye që të jenë pjesë e projekteve dhe zhvillimeve që janë në interesin e tyre, e këtu i keni, pra, shifrat e buxhetit 2024 është 14,781,718.00 euro, që është dukshëm më i mirë sesa buxheti i vitit të kaluar, që ka qenë 13,051,000.00 euro, dhe kështu ngrihen dmth për çdo vit, dmth për vitin 2025 dhe 2026, ky buxhet i planifikuar për vitin 2024 dmth është i përberë prej të hyrave vetanake, që janë planifikuar 1,432,000.00 euro.

Buxheti i të hyrave ju veç e dini që krijohet nga qiratë, nga bizneset, nga tatimi në pronë dhe nga gjobat, ato mjete janë mjete të komunës dhe shfrytëzohen normal për interesin e qytetarëve tanë, ndërsa nga grandit qeveritar i kemi kësaj here 13,361,000.00 euro, që në njëfarë forme janë të ndara në këto kategoritë të cilat ne përballemi në vitin kalendarik.

Paga dhe mëditje janë pjesa dërrmuese 7,830,000.00 euro, dmth po e shihni që grandit për paga dhe mëditje është dukshëm më i madh, për faktin se ka ndodhur Ligji i pagave e që një pjesë e administratës komunale tash ka pagë më të madhe se që ka pasur në të kaluarën, po ashtu edhe të mëditjet dhe paushallët tjerë që janë dukshëm më të larta për disa kategori që përfitojnë nga kjo, mallra dhe shërbime janë 1,710,000.00 euro, shërbime komunale janë 250,000.00 euro, subvencione që kryesisht janë në Zyrën e kryetarit ashtu siç e dini ju, janë të planifikuara 500,000.00 euro. Këtu kryesisht hynë pagesat për personat e rasteve të vdekjeve, për raste të lindjeve, për probleme shëndetësore, por edhe për ndonjë marrëveshje që kryetari mund të arrijë në organizatë të caktuar për kur kërkohet bashkëfinancimi, dhe në fund është pjesa më kryesore që i intereson qytetarit, është grandit ose shpenzime për projekte kapitale që është në vlerë prej 4,500,000.00 euro, dmth këtu ndoshta qytetarët mund të japin kontributin më të madh që kjo shumë për projekte kapitale të shfrytëzohet në bazë të vullnetit dhe interesave që qytetarët kanë për ta realizuar këtë buxhet dhe për t'i arritur ato synime dhe ato projekte që ata kanë nevojë më së shumti.

Unë më tepër nuk isha lëshuar, nëse dikush ka nevojë për të sqaruar ndonjë çështje të caktuar, do të jem i hapur, por edhe njëherë po ju them, ju kisha bërë lutje meqë ende ka hapësirë, që ju dhe qytetarët të bëheni pjesë e debateve në terren për këtë Kornizë Afatmesme Buxhetore, faleminderit!

Fadil Gashi, Kryesues: Faleminderit, drejtor! Unë po hap debat rreth Kornizës Afatmesme Buxhetore, nëse ka dikush, urdhëroni, po, Tunë Deda?

Tunë Deda: Përshëndetje për ju kryesues, përshëndetje për ju drejtorë, përshëndetje për të gjithë të pranishmit, për përfaqësuesin e OSBE-së! Unë e pash, por nuk pata shumë kohë ta lexoj, porsa e mora, është një kërkesë e imja personale, që të parashihet gjatë këtyre viteve 2024-2026 në Kornizën Afatmesme Buxhetore, që çdo pëllëmbë tokë që është e mundshme të ujitet. Parashihet të ndahet buxhet për rregullimin e pendëve dhe kanalizimeve për ujitje, edhe e kam një kërkesë, që në Deiq i merr uji sa herë që bie shi disa shtëpi aty, që të ndahet buxhet për vitin e ardhshëm të kryhet një kanal, të bëhet me beton, që këto shtëpi të shpëtojnë nga vërshimet, kaq kam.

Fadil Gashi, Kryesues: Faleminderit, Tunë! Po, urdhëro, drejtor?

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Faleminderit, Tunë! Këto dy çështje që ju i ngritët, kanë qenë

pjesë e debatit të brendshëm edhe të kryetarit me ne ekzekutivin, dhe zotimi i kryetarit dhe i yni do të jetë që do të bëhet një incizim i terrenit në përgjithësi për problemet që i kemi te vërshimet, dmth prej këtij viti po edhe viteve në vijim patjetër , dhe e dyta; edhe unë dakordohem dhe kemi pasur kërkesa edhe në Bord, që grandit ose mjetet për bujqësi të rriten në këto vite vijuese, për shkak se kanë nevojë njerëzit ta punojnë tokën. Ne e kemi pasur sivjet, veç interesimi për serra e për gjëra tjera ka qenë jashtëzakonisht i madh dhe ne do të shikojmë që realisht t'i ofrojmë me ato mundësi që i kemi njerëzve që janë të interesuar ta punojnë tokën, ta ujinin edhe të pajisen me mjete të caktuara .

Fadil Gashi, Kryesues: Faleminderit, drejtor, dikush tjetër?

Tunë Deda: Unë thash që të parashihet në kornizë, të ndahen mjetet, të ndryshohet kjo që është e propozuar, të dalin në terren për incizime edhe brenda këtyre viteve, dmth 2024-2026, mos të na mbetet neve asnjë pëllëmbë tokë ku është e mundur të ujitet pa e pasur të rregulluar sistemin e ujitjes, do të thotë sistemi i ujitjes është ngritjen e pendëve edhe hapjen e kanaleve të ujitjes. Jam i sigurt se përmbi 30% nuk është e mbuluar me ujitje komuna e Klinës në ato vende ku ka mundësi, p.sh., duke e paraparë prej Stupe e deri në Dollovë, që është një tokë e shkëlqyeshme për zhvillimin e bujqësisë, edhe prej Poterqit deri në Dollovë, njëjtë, nuk është përmbi 30% . Ka mundësi, ne po e shohim që ka probleme me prodhimet bujqësorë dhe ka mungesë. Mallrat e importuara po thonë janë kancerogjene, nuk guxojmë as t'i hamë, tash t'i bëjmë edhe ne prodhimet tona, kaq pata. Unë jam i sigurt që ka mundësi komuna për t'i lënë disa rrugë, për t'i lënë disa gjëra tjera edhe me ju të angazhohemi për rregullimin e këtyre punëve, faleminderit shumë.

Fadil Gashi, Kryesues: Faleminderit, dikush tjetër? E keni pak më ndryshe, sepse po e shoh që, ne, këtë vit, edhe në vizion, edhe në zhvillimin ekonomik, edhe në strategjinë që ne veç jemi duke e punuar strategjinë zhvillimore, që ka obligim të harmonizohen njëra me tjetrën, është edhe përfshirja në bazë të gjinive, duke i përfshirë edhe burra, gra, vajza, djem, edhe në fund është një analizë sepse po kemi nganjëherë keqkuptime në ndërtim të këtyre dokumenteve, kush përfiton. Ne po mundohemi sa e sa herë ta sqarojmë, edhe kur është fjala te buxheti gjinor se ne kemi performancën më të rëndësishme se edhe na kërkohen edhe nga faktorë tjerë, edhe nga organizatat, qofshin qeveritare dhe joqeveritare, si është ndarja e buxhetit gjinor. Prandaj po besoj që pak më në detaje është në këtë vit i shkoqitur, duke i përfshirë edhe analizën edhe orientimet e shpërndarjeve të projekteve te përfitimet e këtyre të mirave materiale, që kthehen te qytetarët, te secila kategori. Prandaj, këto shuma që janë të orientuara, këto kanë mundësi të riparohen, se ne pas saj kemi pastaj buxhetin për vitin 2024, kemi kohë për t'i marr e për t'i orientuar ende, duke i inkurajuar.

Siç e tha edhe drejtori, aty ku e shihni se ka arsye, ku e shihni se ka nevojë, aty ku e shihni se janë më me prioritet, kudo që ju vlerësoni që duhet të intervenohet, që ka kohë ende derisa të shkojmë në Kuvend. Kur të shkojmë në Kuvend, kjo e merr formën e vet edhe pastaj në bazë të kësaj ne fillojmë ta ndërtojmë buxhetin, a ka dikush? Nëse s'ka, kush është për ta rekomanduar për Kuvend?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të Draft-Kornizës Afatmesme Buxhetore 2024-2026, me 6 vota PËR, rekomandoi për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 4. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Drejtorisë së FEZH për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake.

Fadil Gashi, Kryesues: Ne e kemi besoj edhe kërkesën edhe shkoqitjen e shpërndarjes, të bartjes realisht, si kërkohet, po veç ju kisha lutur që mos mendoni që është hera e parë, po më duket që kjo është hera e tretë që këto mjete i marrim, i heqim, i vëmë. Tash na i ka lejuar prapë qeveria, prape duhet marrë në vendimin tjetër, edhe e mira është që ne i kemi tash edhe këto mjete edhe janë të orientuara kështu si e kanë bërë propozimin. Nëse dëshiron drejtori edhe pak të na sqarojë, ju kisha lutur edhe pastaj kishim hapur debat?

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Faleminderit, kryesues! Ashtu si e thatë edhe ju, dmth këto janë mjete që janë votuar njëherë në këtë Kuvend, dmth që është dashur me nxjerrë vendim tjetër ne, me i anuluar për shkak të vendimit të qeverisë së Kosovës, që bëhet kah fundi i vitit 2022, i ka tërheq ato. Vlera e kësaj shume ka qenë 346.194.00 euro, por pas një rezistence si e keni parë ju, të subjekteve tjera politike dhe të Kuvendit dhe këto mjete qeveria ka vendosur të na rikthejë, dhe ky vendim ka ardhur edhe ne prapë kemi qenë të obliguar që ta kthejmë këtë buxhet në Kuvend, që të krijohet një vendim i ri. Kryesisht shpenzime që kanë qenë të planifikuara janë përgjithësisht ato që kanë qenë edhe më herët, në kuadër të kësaj shume me ndryshime të vogla. Tash po e shihni këtu që, mallra dhe shërbime janë ndarë në 6,000 00 euro; shpenzimet komunale bëhen prej 3,374.57 euro; dhe pjesa dërrmuese ka mbetur prapë në shpenzime për kapitale, që vlera e tyre është 336,820.00 euro. Dmth, unanimisht janë po ato mjete siç i keni votuar edhe më herët, por me vendimin e qeverisë për marrje, dmth ne e kemi anuluar, tash po kërkohet prapë një vendim i ri që me vendimin e kuvendit në seancën e ardhshme ne duhet të dërgojmë prapë në Ministrinë e Financave dhe në thesar, që ato mjete dmth t'i kemi ne në dispozicion për realizimin e këtyre projekteve, ashtu siç i kemi paraparë bashkërisht, faleminderit.

Fadil Gashi, Kryesues: Faleminderit, drejtor! Po hap debat, Tunë Deda?

Tunë Dedaj: Po, kryesues, po më vjen shumë mirë që qeveria më në fund ka marr vendim për kthimin e tyre. Është dashur me i lejuar komunës me kohë që të punohet me to, edhe unë pajtohem me këtë parapamje, por desha ta bëj një pyetje për drejtorin: A ka mundësi nga këto mjete që janë për shpenzime kapitale, të parashihet që të rregullohet kanali, që mos të ketë vërshime në Krushevë të Vogël dhe në Deiq?

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Faleminderit, Tunë! Pjesa e kanaleve të ujitjes dhe ato që i thatë më herët ju, dmth ato hyjnë në projekte tjera, jo në kuadër të saj, për faktin se këto veç kanë qenë të planifikuara më herët edhe nuk kemi mundur të bëjmë lëvizje shumë, përqindja më e madhe duhet të shkojë aty si i kemi votuar njëherë në Kuvend. Kështu që, pjesa që ju po e

kërkoni, ajo hyn në projekt të ri të këtij viti, që janë projekte buxhet i rregullt dhe në planifikimin e buxheteve të ardhshme në vijim.

Fadil Gashi, Kryesues: Faleminderit, drejtor! Dikush tjetër? Urdhëro, Mendehie?

Mendehie Duraku: Faleminderit, kryesues, përshëndetje për të gjithë! Meqenëse qeveria e ka lejuar shfrytëzimin e këtyre mjeteve, desha ta pyes drejtorin se çfarë ndodh me këto mjete nëse nuk arrijnë të shfrytëzohen këto para, sepse jemi në muajin e gjashtë të këtij viti 2023, çfarë ndodh me këto para, nëse ne nuk arrijmë t'i kryejmë gjitha këto projekte që i kemi?

Enver Berisha, drejtor i DUMM: Faleminderit, e nderuara Mendehie! Realisht nuk do të ketë këso probleme në shpenzimin e këtyre mjeteve, për shkak se ne këto mjete i kemi planifikuar më herët dhe këto projekte dhe këto gjëra që kanë qenë në kuadër të këtij buxheti, do të fillojmë menjëherë me u shpall dhe me filluar, për shkak se ka qenë e planifikuar dhe unë besoj që kësaj here, jam i bindur që këto mjete do të realizohen një për një brenda këtij viti.

Fadil Gashi, Kryesues: Faleminderit, dikush tjetër? A ka dikush tjetër?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të propozimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake nga viti 2022 në vitin 2023, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, me 6 vota PËR, rekomandoi që ky propozim të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 5. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa, për muajin maj-qershor 2023.

Kërkesë nga OJQ “ZANA”

I nderuar kryetar Elezaj, OJQ “Zana” është themeluar në vitin 2022, dhe që nga atëherë përmes projekteve të ndryshme nga donatorë ndërkombëtarë dhe vendorë, ka ndihmuar grupet me nevojë, siç janë: gratë, fëmijët me nevoja të veçanta dhe minoritetet RAE. Që nga viti 2018 në kuadër të OJQ “Zana” vepron edhe Qendra e Kujdesit Ditor, ku deri më tani kanë marrë shërbime rreth 130 fëmijë me autizëm-sindrom Down dhe me dëmtime të lehta psikologjike. Fondet që kemi shfrytëzuar për zbatimin e projekteve tona, janë kryesisht nga Institucionet e Republikës së Kosovës: Qeveria dhe Komuna, Bashkimi Evropian, USAID, nga organizata e Kombeve të Bashkuara dhe nga ambasadat e akredituara në Kosovë. Herë pas here, ne, po ashtu kemi pasur donacione nga biznese private të Komunës së Klinës. Të gjitha aktivitetet e OJQ “Zana” janë përfshirë edhe të hyrat, janë raportuar disa vite në Ministrinë e Administratës Publike si dhe në ueb-faqen e organizatës.

Komuna e Klinës ka qenë një nga mbështetësit kryesor të aktiviteteve tona, duke na ndihmuar me hapësirat për zyra, që nga viti 2012.

Mirëpo, në dy vitet e fundit, hapësira që ne e shfrytëzojmë është vërshuar në vazhdimësi nga shirat dhe si pasojë zyrat kanë pësuar dëmtime të theksuara. Duke pasur parasysh se ne aktivitetet tona i realizojmë edhe me fëmijë, hapësirat aktuale të zyrave, për shkak të

kundërmimit dhe mykut, janë bërë të dëmshme, sidomos për shëndetin e fëmijëve por edhe për stafin e organizatës.

Prandaj, po ju drejtohem juve me kërkesë për të na ofruar një hapësirë për zyre, rreth 180 m² katrorë, të përshtatshme për realizimin e aktiviteteve tona, sidomos aktiviteteve me fëmijët me nevoja të veçanta që ne i realizojmë në kuadër të Qendrës Ditore për fëmijë.

P.s: Ne kemi biseduar me biznese që dhurojnë donacione, pronari i “Market Nora” është shprehur i gatshëm të ndihmojë në rregullim të hapësirave, vetëm ka kërkuar dokumentin nga ana e Komunës për ndërrim të hapësirave për OJQ “ZANA”, Klinë.

Fadil Gashi, Kryesues: Të njëjtën kërkesë besoj e keni edhe ju. Po, urdhëro drejtor?

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Kërkesa e OJQ “ZANA” ka ardhur në Zyrën e kryetarit, ka ardhur edhe në Drejtorinë e Financave. Ajo e ka një zyre në shfrytëzim edhe po kërkon një hapësirë tjetër, por ne jemi në një proces të ri sa i përket lokaleve që janë dmth pronë e komunës edhe jemi duke e bërë një lloj rivlerësimi të pronës së komunave, duke përfshirë lokalet dhe banesat. Jemi duke planifikuar që ta vëmë në ankand krejt këtë potencial që do ta kemi si komunë, të lokaleve që janë pronë komunale dhe OJQ “ZANA” ndoshta këtë punë nuk e di, por nuk ka më për të dhënë Drejtoria ose individit pronë në shfrytëzim të komunës, por duhet përmes një ankandi, përmes prokurimit. Ne nuk mund ta bëjmë vetëm për një lokal, por ne po shikojmë që ta bëjmë një shpallje publike për gjitha lokalet që janë aset i komunës dhe aty të mund të aplikojnë të gjithë. Këtë të drejtë me siguri do ta ketë edhe OJQ “ZANA”.

Fadil Gashi, Kryesues: Atëherë, për të qenë pak më të qartë për anëtarët e KPF-së, krejt çka unë e kuptova prej drejtorit, se duhet me ja lëshuar Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim të Hapësirave Publike, edhe një prej atyre kriterëve është që, ne, asnjë metër nuk guxojmë ta japim pa i zhvilluar procedurat e ankandit. Është një telashe dhe pakënaqësi e të gjitha organizatave joqeveritare në nivel të Kosovës, pikërisht për këtë pjesë. Por derisa nuk ndryshon ligji, ne, s’ mund të ndryshojmë as këtë kriter, sepse ka këso kërkesa prej organizatave joqeveritare, sepse arsyeja e tyre është që ne nuk mund të aplikojmë në ankand karshi disa bizneseve që ata kanë interes me marr atë të lirë, edhe ne s’ mund të konkurrojmë me ta. Është shumë e arsyeshme, por ligji e ka përcaktuar kështu këtë kriter edhe s’ mundet as komuna dhe askush, derisa të ndryshohet ligji në Parlament të Kosovës. Po, urdhëro, Mendehie?

Mendehie Duraku: Faleminderit, kryesues! Unë thjesht nuk e kam kuptuar shumë mirë këtë kërkesën e OJQ “ZANA”. Sa kam informacion, unë e di që kjo OJQ shfrytëzon dy lokale, tash desha të di që se cila është pronë e komunës apo janë të dytë?

Dmth të dyjat janë? Se ajo kërkesën e ka bërë që edhe si lokal, që kërkon shfrytëzimin e aktiviteteve për fëmijët me nevoja të veçanta. Siç e dimë, shkojnë plot fëmijë, por siç ka potencuar ajo aty në kërkesë, ka thënë që është marrë disa herë nga vërshimet. Unë e di që aktivitetin me fëmijët ajo nuk e bën në atë lokalin atje ku e kanë marr vërshimet, thjesht e bën në këtë lokalin e Benites këtu më duket. Thjesht desha ta di se për cilën kërkon lokal, kërkon për aty ku i bën aktivitetet me fëmijët apo aty ku i ka zyrat e veta? Kaq, faleminderit!

Fadil Gashi, Kryesues: Për aktivitete me fëmijë.

Tunë Dedaj: Po, kryesues, unë mendoj që ata që kryejnë punë pa lekë është mirë t'i dalim në ndihmë, por, sa jam i informuar këto paguhen prej atyre prindërve edhe nuk e di që komuna ka obligim t'jua jap. Një kërkesë të tillë e ka bërë edhe shoqata "Nënë Tereza", për të pasur një hapësirë ku ju ndihmon të varfërve, edhe s'ka pasur mundësi me jua dhanë për shkak të ligjeve në fuqi që janë, është që dy vite ajo kërkesë edhe s'ka pasur mundësi.

Edhe shoqata e "Pensionistëve" është edhe më e arsyeshme me jua dhanë, edhe më e arsyeshme se çdo gjë, se pensionistët e meritojnë një tretman krejt të veçantë, nëse ka mundësi, atyre me jua dhanë është më mirë se çdokujt tjetër. Por desha të them që ato shoqata që paguhen, që marrin para prej prindërve, prej fëmijëve që janë me nevoja të veçanta, komuna nuk e ka obligim që t'ia sigurojë, bile ndoshta edhe ato që e kanë, mendimi im është se janë të tepërta.

Fadil Gashi, Kryesues: Dikush tjetër? Ne, besoj edhe si kuvend, edhe si ekzekutiv, kemi vullnet ta ndihmojmë secilin që ka nevojë prej familjeve, por ne duhet t'i shikojmë rrugët ligjore dhe rrugët procedurale, ku ne nuk bëjmë shkelje sepse duke shkelur ligje, procedura, nuk i ndihmojmë askujt. Nëse pajtoheni ju si KPF, ne përgjigjen duhet ta japim si institucion, ne e rekomandojmë nëse dëshironi për Kuvend, ne mund ta ndërpremë rrugën e saj edhe këtu. Ky Komitet, për zonat që i sheh që nuk kanë rrugë për më tutje, i ndal këtu, i ka kompetencat ky Komitet, për atë është Komitetit para Kuvendit. Ne jemi filtri i fundit, prandaj jemi ne këtu, për atë ne kur marrim vendim, themi po e rekomandojmë, kur themi nuk e rekomandojmë, do të thotë se kjo kërkesë merr përgjigje prej KPF-së, i dërgohet atij që na është drejtuar, edhe arsyetohet baza pse ndalet kjo. Po, urdhëro drejtor?

Binak Sylja, drejtor i Administratës: Përshëndetje për kryesuesin dhe për të gjithë ju të pranishmit!

E tha edhe kryesuesi, e tha edhe drejtori pak më parë, lista e dhënieve në shfrytëzim të lokaleve edhe banesave që janë të planifikuara nga ekzekutivi dhe nga Kuvendi, besoj që ka kaluar edhe te Kuvendi, ju e dini mirë se një listë e hartuar që është marr nga ekzekutivi për të gjitha lokalet që është e mundshme m'i dhanë në shfrytëzim, ka kaluar edhe këtu. Kemi kërkesa të ndryshme edhe nga shoqata të dala nga lufta dhe në shoqatën e të pagjeturve dhe kërkesa të tjera, të cilave nuk kemi mundur me jua dhanë ndonjë zgjidhje tjetër përpos kësaj që e thamë. Absolutisht asnjë mjet nuk mund të jepet në shfrytëzim pa procedurë prokurimi, procedura e prokurimit i do disa procedura tjera të ndjekjes dhe të gjithë janë të barabartë, të gjithë mund të konkurrojnë.

Ne e dimë se vlerë më të madhe se shoqatat e dala nga lufta nuk kemi ne si popull këtu, po megjithatë nuk kemi mundur as atyre me jua dal mundësinë dhe me jua dhanë hapësirë tjetër, përpos atyre që e kanë qysh e kanë për momentin. Ato janë në shfrytëzim, siç e ka edhe OJQ "ZANA" edhe në të kaluarën, edhe e ka prej fillimit në shfrytëzim, po ashtu, sikur e kanë të gjitha OJQ-të e tjera, mendoj që kjo është e vetmja mundësi, ashtu siç e tha edhe kryesuesi.

Mendoj që duhet të përfundojë këtu ky epilog edhe m'i dhanë mundësi aplikimit me thirrje publike, ku bëhet me rastin e prokurimit te avokati.

Fadil Gashi, Kryesues: Faleminderit, drejtor! Po, Tunë?

Tunë Deda: Atë që e tha Binaku, e kisha në plan ta them edhe unë dhe pajtohem me mendimin e tij.

Fadil Gashi, Kryesues: Faleminderit, dikush tjetër? Atëherë ne e ndërtojmë përgjigjen edhe i kthejmë përgjigje duke ju nënshtruar procedurave të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim të Hapësirave Publike. Kush është për?

-Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga OJQ “ZANA” për sigurimin e një hapësire për zhvillimin e aktiviteteve të OJQ-së, me 6 vota PËR, rekomandoi që OJQ “ZANA” të aplikojë me rastin e shpalljes së dhënies në shfrytëzim pronat komunale, procedura të cilat i parasheh Ligji Nr.06./L-092 dhe Rregullorja (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës.

Pika 6. Të ndryshme.

Fadil Gashi: Ju e dini se muajin gusht e kemi pushim në kalendar, edhe unë kam biseduar edhe me kryetarin, ne e kemi pasur një vizitë të planifikuar në qershor, e kemi zhvendosur qershorin, por nëse jeni dakord që s’duhet të zhvillohet ajo vizitë në këtë vit, ne jemi në rregull. Ne duhet ta dimë sepse akoma jemi në bartje të mjeteve, se nuk ka mjete, sepse janë harxhuar një pjesë e mjeteve në përfshirje të llaptopëve aty ku i kemi pasur edhe nuk kemi mjete të orientuara, prandaj duhet me i ndihmuar edhe ekzekutivit, kryetarit e drejtorisë, gjithëve, për të ditur me i orientuar mjetet, por nuk kisha dashur me e marr me kaq neglizhencë këtë punë.

Deri në seancë është mirë të bisedojë secili prej jush e prej nesh edhe t’i dimë orientimet tona që ndihmojnë ekzekutivin, duke mundur t’i gjejë mjetet e m’i orientuar mjetet që duhen ose që janë të nevojshme për me e realizuar këtë vizitë, nëse jo, e vendosni ju, nuk kemi ndonjë obligim sepse ashtu kështu mjetet nuk janë, s’kemi obligime tjera. Urdhëro, Tunë?

Tunë Dedaj: Po, kryesues, faleminderit! Ne e kemi bërë këtu vendim, se s’kemi sjellë vendim këtu për të shëtitur në Turqi, por kemi thënë se duam të shkojmë për një vizitë pune edhe atë vizitë pune është mirë për ta realizuar. S’ka rëndësi që është shtyrë, ta realizojmë në muajin shtator edhe t’i parashohim mjetet edhe t’i gjejmë mjetet për të shkuar, se ne këtu në Kuvend e kemi sjellë këtë vendim edhe nuk e di pse është neglizhuar kështu. Unë jam për të shkuar edhe po besoj që edhe kolegët e mi më përkrahin, se ajo vizitë nuk është për shëtitje, nuk është ekskursion, është vizitë pune.

Fadil Gashi, Kryesues: Ne e kemi parë edhe në kalendar, është vizitë pune, ne nuk mund të ja ndërrojmë emrin, as nuk është diçka që s’është duke ndodhur për secilin Kuvend Komunal, po e kemi pasur bisedë me kryetarin edhe kanë nevojë për ta ditur dhe për ta sqaruar edhe njëherë. Po, urdhëro, drejtor?

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Është mirë, kryesues, brenda këtij afati deri në seancë që edhe ne bashkë me kryetarin, me këqyr ku janë mundësitë, se këto janë në kuadër edhe të Kuvendit, të shikojmë a janë të pajtimit të shkojnë apo jo. Atëherë vendimi i Kuvendit dihet që pavarësisht kalendarit që është, por nëse duhet edhe një rikonfirmim i anëtarëve të Kuvendit, pse jo në

seance me bërë edhe me i obliguar, me i gjetur mjetet edhe me i realizuar, edhe në fund, kryesues, është mirë ju të mendoni për debatin që duhet të mbahet, për Kornizën Afatmesme Buxhetore, në kuadër të Kuvendit.

Fadil Gashi, Kryesues: Po, ne veç e kemi caktuar datën , më 27 qershor e kemi debatin me publik këtu, mirë ka qenë edhe ju anëtarët e KPF-së të merrni pjesë. Nëse nuk keni diçka tjetër, unë po e përfundoj mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa. Faleminderit për pjesëmarrje!

Procesmbajtësja,
Monika Palushi

KRYESUESI,
Fadil Gashi



REPUBIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Komuna e Klinës

Zyra e kryetarit

